

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përberë nga gjyqtarët: Enver Peci, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Emine Kaçiku, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, si procesmbajtës, në kontestin administrativ sipas padisë së paditëses, Kompania e Sigurimeve "I." Sh.a, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Autoriteti Kosovarë i Konkurrencës, në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.23/2016 të datës 31.05.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23.01.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e paditurës, Autoriteti Kosovarë i Konkurrencës në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.23/2016 të datës 31.05.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.23/2016 të datës 31.05.2016, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditurës Autoriteti Kosovarë i Konkurrencës në Prishtinë, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.96/11 i datës 04.11.2015.

Pala e paditur kësaj gjykate i ka parashtrua kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr. 23/2016 të datës 31.05.2016, për shkak të shkeljes së drejtës materiale dhe

dispozitave të procedurës, me propozim që aktgjykimi i atakuar të anulohet dhe të vendoset meritorisht ose lëndën ta kthejë në rishqyrtim e rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës në bazë të nenit 53. të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, kërkesës së paditurës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lendes ka gjetur se:

Kërkese është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.23/2016 të datës 31.05.2016, është refuzuar si pa bazuar ankesa e të paditurës, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.96/11 i datës 04.11.2015, me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditësit pastaj është anuluar vendimi i të paditurit nr. 5/6 i datës 27.12.2010 dhe paditësi është liruar nga sanksioni administrativ prej 100.000 (njëqindmijë euro) i shqiptuar nga i padituri.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar, shkresat e lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se gjykata e shkallës së dyte drejt ka vepruar kur ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e të paditurit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, nga se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshi me shkelje të dispozitave të procedurës administrative e as të drejtës materiale siç pretendon paditësi në kërkesë.

E paditura në kërkesë për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë mes tjerash pretendon se, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale nga neni 180 të LPK-së, pasi që nuk ka bërë analizimin e provave veç e veç dhe në raport reciprok e që kanë qenë më rëndësi për vërtetimin e fakteve kontestuese. Pretendon se aktgjykimi përmban të meta për shkak të cilave nuk mundë të ekzaminohet, mungojnë arsyet për

faktet vendimtare, ndërsa dispozitivi është i paqartë dhe kontradiktor e po ashtu arsyetimi është në kundërshtim me provat të cilat ndodhen në shkresat e lëndës duke pretenduar me këtë rast se ka shkelje nga neni 182.1 të LPK-ës, të cilat shkelje procedurale konsideron se kanë qenë me ndikim të drejtpërdrejt në konstatimin e gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike. Po ashtu pretendon se ka shkelje të drejtës materiale nga neni 3.2 të Ligjit nr.2004/36 për Mbrojtjen e Konkurrencës duke mos konstatuar gjendje të drejt të fakteve ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Përkitazi me pretendimet për shkelje esenciale të dispozitave procedurale e paditura në kërkesë potencon, shkeljet nga gjykata e shkallës së parë pa pretendime të qarta sa i përket aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë. Sipas dispozitës së nenit 24 të Ligjit për Konfliktet Administrative pala mundë të parashtrij Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë. Megjithëse, e paditura në kërkesë atakon aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative si shkallë e dytë, në arsyetimin e kërkesës siç u cek më lartë përmenden vetëm shkeljet esenciale të pretenduara të gjykatës së shkallës së parë. Sipas dispozitës së nenit 53 të LKA-as, lidhur me kërkesën gjykata vendos vetëm brenda kufijve të saj. Megjithatë, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyerat e nevojshme, sa i përket qëndrimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me shkeljet esenciale të potencuar në kërkesën e të paditurit dhe këto qëndrime i aprovon edhe kjo gjykatë.

Sa i përket pretendimeve të paditurës për shkeljet e së drejtës materiale të Ligjit nr. 2004/36 për Mbrojtjen e Konkurrencës, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se janë të pa bazuara. Në të vërtetë, vendimi administrativ kontestues i të paditurës nr.5/6 i datës 27.12.2010, në dispozitivin e tij në pikën III, me rastin e shqiptimit të sanksionit administrativ prej 100.000 euro, bazohet në nenin 35.1 germa (e) të Ligjit për Konkurrencën. Kushtet esenciale të cilat kërkohen sipas kësaj dispozite ligjore për vendosjen e një sanksioni administrativ i cilësdo ndërmarrje është përfshirja në ekzekutimin, zbatimin ose kryerjen e marrëveshjes ose praktikes në fjalë. Duke vlerësuar provat në shkresat e lëndës, me asnjë provë e paditura gjatë zbatimit të procedurës administrative nuk ka vërtetuar se marrëveshja kontestuese është ekzekutuar, zbatuar ose është kryer në ndonjë rast konkret nga paditësjja. Andaj, meqenëse nuk janë përmbush kushtet esenciale për vendosjen e

sanksionit administrativ sipas dispozitës së ligjit të lartëcekur, kjo gjykatë konsideron se në këtë konflikt administrativ nuk ka shkelje të drejtës materiale siç pretendon e paditura.

Nga të cekurat më lartë, Gjykata Supreme gjeti se gjykata e shkallës së dytë në këtë çështje administrativo-juridike drejt ka aplikuar dispozitat e procedurës administrative, dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative, Ligjit për Procedurën Administrative, Ligjit për Konkurrencën, njashu që thëniet e të paditurës në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, nga se nuk janë me ndikim në vërtetim tjetër të gjendjes faktike nga ajo të cilën e kanë vërtetuar gjykatat e shkallës më të ulët.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm, në arsyetimin e të njëjtit janë dhënë arsye të nevojshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata vlerëson se e drejta materiale drejt është zbatuar dhe se nuk është shkel ligji në dëm të paditurës.

Nga si u tha më sipër, në baze të nenit 54 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVES

Më 23 janar 2017, ARJ.nr.38/2016

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Enver Peci